



VENDIM

Nr. 118 Datë 28.12.2010

**PËR
MOSRPANIMIN E ANKESËS SË KESH SH.A PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 97, DATË
07.12.2010,**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikave 4.2, 4.7 dhe 5.7 të Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr.338 date 23.04.2008, të ndryshuar, nenit 16, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, të miratuar me Vendimin nr.18, date 21.03.2009, Vendimit nr. 77, date 26.06.2008, të Bordit të Komisionereve të ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per kompanine publike te gjenerimit te energjise elektrike”; Vendimit nr. 78, date 26.06.2008, të Bordit të Komisionereve të ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me shumice te energjise elektrike”; Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, mbasi analizoi kërkesën e KESH sh.a per ankimin e vendimit nr.97, date 07.12.2010 dhe relacionin e Drejtorise Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit si dhe Drejtorise se Tarifave dhe Çmimeve për këtë çështje,

Konstaton se:

- Kërkesa e KESH sh.a është paraqitur në ERE, në kapërcim të afateve proçeduriale. (neni 16 i Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s).
- KESH sh.a ka qënë në njohje të plotë të vendimmarrjes së ERE-s, ç`ka e dëshmon edhe prezenca e përfaqësuesve të KESH sh.a në mbledhjen e Bordit të Komisionerëve të datës 07.12.2010, të cilët nuk paraqitën asnjë kontestim dhe për më tepër vlerësuar bashkëpunimin KESH sh.a – ERE. Edhe nëse do të pranohej si datë e marrjes dijeni data 14 dhe jo 13 siç dëshmohej në librin e dorëzimeve të ERE-s e të firmosur nga punonjësi i KESH sh.a, afati maksimal i pranimit të kësaj kërkesë në ERE, do të ishte data 19 Dhjetor 2010 dhe jo data 20.12.2010, që është dhe data e protokollimit të shkresës nga vetë KESH sh.a.
- Në kërkesën të KESH sh.a, ERE nuk konstaton asnjë argumentim që plotëson kërkesat e nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të

ERE-s, për provën apo provat e reja pasi ato të gjitha janë trajtuar si në trajtë pohimesh gjatë seancave dëgjimore ashtu edhe në formë deklarimesh në aplikimin e KESH sh.a apo dhe shkresave të tjera sqaruese (plotësuese të aplikimit).

- Pohimet e perfaqesuesve te KESH sh.a per te rikerkuar shqyrtim te te ardhurave te kerkuara sipas aplikimit te dates 30.08.2010, jo ne kuader te provave te reja, por si nje kerkese per rishikim ne kuader te te ardhurave shtese qe vijne nga perdorimi i te ardhurave nga eksporti i energjise elektrike si dhe te ardhurat (rezerve) nga TEC Vlore sh.a., jane ne kundërshtim me pikat 4.2, 4.7 dhe 5.7 te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi:

1. Mosrpanimin e kerkeses së KESH sh.a për rishikimin e vendimit te Bordit të Komisionerëve nr. 97, datë 07.12.2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.